Kronikë

Shpërndanin kanabis nëpër zona të ndryshme të Sarandës, 2 të arrestuar! Iu gjenden edhe armë e tritol në banesa

Policia e Sarandës ka vënë në pranga dy persona pasi janë kapur me armë dhe kanabis

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
21 Prill, 10:12 | **Përditësimi: 21 Prill, 10:31**

Share

SARANDË-Policia e Sarandës ka vënë në pranga dy persona pasi janë kapur me armë dhe kanabis.

Gjatë operacionit "Strike 11",në Sarandë, u arrestua në flagrancë A. S., 35 vjeç, banues në Sarandë, me precedent kriminal në fushën e narkotikëve.

Policia thotë se bazuar në informacione kanë ushtruar kontroll fizik ndaj 35-vjeçarit, të cilit i gjetën dhjetëra doza lëndë narkotike cannabis, të cilat ky shtetas i shiste në zona të ndryshme të Sarandës.

LEXO EDHE:
Reshjet e shiut në Vlorë, bllokohet qarkullimi nga përmbytja në lagjen 'Rilindja'

Gjatë kontrollit në banesën e tij, në Sarandë, policia gjeti dhe sekuestroi 1 armë zjarri kallashnikov, 1 kallëp tritoli, 1 krehër me municion luftarak, një sasi lëndë narkotike cannabis, një sasi farash cannabisi dhe një shumë parash të dyshuara të falsifikuara.

Ndërkohë në kuadër të operacionit 'Strike 12',në Ksamil, u arrestua në flagrancë shtetasi S. M., 46 vjeç, banues në Ksamil, me precedent kriminal në fushën e vjedhjes.

Gjatë operacionit, policia ka ushtruar kontroll në banesën e 46-vjeçarit, në Ksamil, ku gjetën dhe sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë, 1 mjet prerës (thikë), 1 palë pranga, disa fishekë arme gjahu, një shumë parash në euro dhe 8 celularë.

Materialet procedurale për të dyja rastet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Vlorë sarandë kanabis

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Rithemelimi propozon rikthimin e koalicioneve të vjetra, a jeni dakord?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Gjysmëmaratona në Vlorë, 1200 garues nga e gjithë bota! Në garë dhe nxënësit e shkollave
21 Prill, 10:22

Fshati mes agrumeve, Lukova ndër destinacionet më të preferuara në bregdetin jonian! Çmime më të lira se Saranda dhe Himara
Limos Didani
21 Prill, 09:10

Krujë/ Kishte mbjellë 45 fidanë kanabis pranë banesës, arrestohet 51-vjeçari
20 Prill, 13:17

Gjermani/ U legalizua në fillim të Prillit, gjoba të larta për përdorimin e kanabisit në timon
19 Prill, 16:32

Vlorë, lëvizte me armë me vete, arrestohet 34-vjeçari
18 Prill, 11:26

Media amerikane: Ksamili, vendpushimi mesdhetar i ngjashëm me Maldivet
18 Prill, 08:59

Kopshtar në fermën e kanabisit në Skoci, dënohet ish-polici nga Saranda: Më kërcënoi gangsteri që arrestova
17 Prill, 17:20

Media italiane: Eksploroni destinacionet më të mira të pushimeve në Shqipëri
17 Prill, 09:20

VIDEO/ Vatër zjarri në Nartë të Vlorës
16 Prill, 21:19

Gjirokastër, ndalohet 'Jaguar' me dy thasë me kanabis brenda, me një makinë tjetër monitorohej rruga
16 Prill, 12:30

Korçë/ Drogë me ushqimet, arrestohet një person brenda burgut të Drenovës
Armand Braho
15 Prill, 20:17

Himarë, po ndërtonte pa leje në tokën e një shtetasi tjetër në Livadh, arrestohet 38-vjeçari
15 Prill, 12:02

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje